



VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM  
ODLUKA JE PRAVNOSNAŽNA  
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD  
FERIZAJ I UROŠEVAC

P.nr.2028/17

Më  
Dana

29 - 06 - 2018

NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ- Departamenti i përgjithshëm divizioni penal**, si gjykatë e shkallës së parë penale, në përbërje nga gjyqtari individual Adem Shabani me zyrtarin ligjor Blend Rexhepi sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.9-5/16 e dt.16.08.2017, në çështjen penale kundër të akuzuarëve: [REDACTED] dhe [REDACTED] që të tre nga Ferizaji rruga " [REDACTED] ", me të cilën në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor neni 188 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor me dt.16.01.2018, në praninë e përfaqësuesit të akuzës prokurorit të shtetit Bahri Hyseni, të akuzuarëve dhe të dëmtuarit [REDACTED] të njejtën ditë mori dhe publikisht komunikoi kete:

AKT GJYKIM

1. [REDACTED] nga Ferizaj rruga " [REDACTED] ", i lindur më [REDACTED] në Ferizaj, nga i ati [REDACTED] dhe e ëma [REDACTED] e gjinisë [REDACTED] shqiptarë, shtetas i Republikës së Kosovës, i martuar babë i tre fëmive, gjendjes së mesme ekonomike, ka të kryer shkollën fillore, mbrohet në liri me numër personal [REDACTED].
2. [REDACTED] nga Ferizaj rruga " [REDACTED] ", i lindur më [REDACTED] në Ferizaj, nga i ati [REDACTED] dhe e ëma [REDACTED] e gjinisë [REDACTED] shqiptarë, shtetas i Republikës së Kosovës, punëtor, gjendjes së mesme, ka të kryer shkollën e mesme, i martuar baba i një fëmije mbrohet në liri me numër persona [REDACTED].
3. [REDACTED] nga Ferizaj rruga " [REDACTED] ", i lindur më [REDACTED] në Ferizaj, nga i ati [REDACTED] dhe e ëma [REDACTED] e gjinisë [REDACTED] shqiptarë, shtetas i Republikës së Kosovës, punëtor- salldues, gjendjes së mesme, , ka të kryer shkollën e mesme juridike, i martuar baba i tre fëmive mbrohet në liri me numër personal [REDACTED].

JANË FAJTOR

SEPSE:

Me dt. 16.01.2016, rret horës 09:20 në Ferizaj rruga " Dëshmorët e Kombit " saktësisht te Xhamia e Madhe, të pandehurit në bashkëkryerje, derisa i dëmtuari [REDACTED] kishte qenë duke pritur për ti transportuar kufomat pasi që ka qenë fitues i tenderit për transportin e kufomave, të pandehurit kanë shkuar që edhe ata të transportojnë kufomat dhe pas një mosmarrëveshje ndërmjet tyre, të pandehurit e kanë sulmuar fizikisht të dëmtuarin me grushte dhe shqelma duke i shkaktuar lëndime trupore me dëmtim të përkohshëm të shëndetit të përshkruara si në ekspertizën mjeko ligjore të datës 18.05.2017.

*-me të cilën në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor neni 188 par.I lidhur me nenin 31 të KPRK-së*

Gjykata në bazë të dispozitës së lartë përmendur dhe neneve 4, 7, 17, 23, 41, 42, 43, 51, 52, dhe 73 të KPK-së dhe nen. 365 të KPPK-së i

## GJYKON

I. Të akuzuarin [REDAKTUAR], i shqiptohet dënim burgimi në kohëzgjatje prej 4 /katër / muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në afatin prej 1 (një) viti, nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen vepër tjetër penale.

II. Të akuzuarin [REDAKTUAR] i shqiptohet dënim burgimi në kohëzgjatje prej 4 /katër / muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në afatin prej 1 (një) viti, nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen vepër tjetër penale.

III. Të akuzuarin [REDAKTUAR], i shqiptohet dënim burgimi në kohëzgjatje prej 4 /katër / muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në afatin prej 1 (një) viti, nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen vepër tjetër penale.

Obligohen të akuzuarit [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] që në emër të shpenzimeve gjyqësore si dhe paushallin gjyqësor në mënyrë solidare të paguajn shumën prej 80 Euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotëfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcënimin e përbarimit me dhunë.

I dëmtuari [REDAKTUAR] nga Ferizaj rruga "[REDAKTUAR]" për realizimin e kërkesës pasuroro-juridike udhëzohen në kontest civil.

## Arsyetimi

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën PP/II.nr.9-5/16 e dt.16.08.2017, i ka ngarkuar të akuzuarit [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] që të tre nga Ferizaji rruga "[REDAKTUAR]", me të cilën në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor neni 188 par.I lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Gjykata duke vepruar në këtë çështje penale ka mbajtur shqyrtimin gjyqësor me dt.16.01.2018, në të cilin gjyqtari ka ftuar të akuzuarit të përcjellin me vëmendje zbatimin e shqyrtimit gjyqësor duke e udhëzuar të akuzuarin në kuptim të nenit 323 paragraf.2.1,2.2 dhe 2.3 të KPPK-së.

Prokurori i shtetit Bahri Hyseni në fjalën përfundimtar ka mbetur në tërësi pran aktakuzës dhe kualifikimit juridik të veprës penale të cilat i vihet në barrë të akuzuarave, nga baza e pranimin të fajësisë nga të akuzuarit i cili pranim gjen mbështetje të plotë edhe në provat tjera të cilat gjenden në shkresat e lëndës u vërtetua se të akuzuarit e kanë kryer vepër penale që i vihet në barrë, i ka propozuar gjykatës që të njëjtit ti shpallë fajtorë dhe ti shqiptoi sanksion penal të paraparë me ligj përmes të cilit do të arrihet qëllimi ndëshkues, ndërsa me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit si rrethana

lehtësuese të akuzuarit ti merr pranimin e fajësisë nga ana e tyre dhe premtimin se më nuk do të përsërisin veprime të tilla dhe i kanë kërkuar falje të dëmtuarit [REDAKTUAR]

I akuzuari [REDAKTUAR] në shqyrtimin gjyqësor ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet, dhe ka deklaruar se mbetet në tersi pranë deklaratës që e ka dhënë në polici dhe në vazhdim në mbrojtjen e dhënë ka theksuar se atë ditë ishte shkuar te Këshilli i Bashkësisë Islame për të bartur kufoma, ku në ato momente kishte dalur i dëmtuari [REDAKTUAR] duke i thënë se largohu nga këtu se unë jam këtu për të bartur kufoma dhe ky ishte momenti ku nuk ka mundur ta kontrollojë vetë i kërkon faje të dëmtuarit është penduar për verën e kryer dhe ka premtuar se më nuk do të përsërisë veprime të tilla, i ka propozuar gjykatës që me rastin e shqiptimit të dënimit të merr për bazë pranimin e fajësisë, pendimin për veprën penale që e ka krye.

I akuzuari [REDAKTUAR] në shqyrtimin gjyqësor ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar se mbetet në tersi pranë deklaratës që e ka dhënë në polici dhe në vazhdim ka deklaruar se atë ditë me vllaun e tij [REDAKTUAR] kishte shkuar te Këshilli i Bashkësisë Islame për ta bartur një kufomë ku i dëmtuari i ka thënë se unë jam këtu dhe me të menjëherë ka filluar mosmarrëveshtja dhe ka ardhur deri te rrahja e ndërhyra që ti ndaj mes tij dhe vllaut [REDAKTUAR] ky në vetëmbrojtje ka filluar të kacafytet me të dëmtuarin i kërkon falje dhe nga ai moment kuk e ka penguar në punë ku të dy palët e ushtrojnë të njëjten zeje atëherë edhe tani i ka propozuar gjykatës që me rastin e shqiptimit të dënimit të merr për bazë pranimin e fajësisë, pendimin për veprën penale të kryer, ka premtuar se më në të ardhmen nuk do të përsërisë veprime të tilla është mbajtës i familjes.

I akuzuari [REDAKTUAR] në shqyrtimin gjyqësor ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet, dhe në vazhdim ka deklaruar se edhe në polici për rastin që akuzohet me datë 21.01.2016 është intervistuar dhe në vazhdim ka deklaruar se ka shkuar te Këshilli i Bashkësisë Islame në Ferizaj pasi që e kishte thirrur në telefon vllaun e tij [REDAKTUAR] dhe ku ka arritur aty është takuar me të dëmtuarin dhe menjëherë i ka tërequr nga aty që mos të ndodhë më e keqe i ka propozuar gjykatës që me rastin e shqiptimit të dënimit të merr për bazë pranimin e fajësisë, i kërkon falje të dëmtuarit dhe ka premtuar se atë nuk do ta pengoj në punën e tij e as të mos kem mosmarrëveshtje gjatë ushtrimit të zezes që e ushtrojmë tu dy palët.

Gjyqtari në shqyrtimin gjyqësor pas pranimit të fajësisë nga ana e të akuzuarave ka vlerësuar se janë përmbushur kërkesat nga neni 326 par.4 i KPPRK-së, pasi që të akuzuarit e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, fajin e kanë pranuar vullnetarisht duke e mbështetur në provat dhe materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit të cilat gjenden në shkresat e kësaj lënde penale dhe shqyrtimi gjyqësor ka vazhduar me fjalën përfundimtareve të palëve komform neni 352 të KPPRK-së.

I dëmtuari [REDAKTUAR] në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se i bashkangjitet ndekjes penale dhe ka kërkuar nga gjykata që të akuzuarit ti shpallë fajtor për veprën penale që akuzohen ka mbetur pranë kërkesës pasuroro-juridike por atë nuk e ka precizuar.

Gjykata në shqyrtimin gjyqësor konstatoi se të akuzuarit veç e veç pranimin e fajësisë e kanë mbështetur në provat që gjenden në shkresat e kësaj lënde dhe atë: në mendimin dhe konstatimit të ekspertit mjeko ligjor të datës 18.05.2017, deklaratat e të pandehurave të dhëna në polici procedurën paraprake dhe të dëmtuarit si dhe në shkresat tjera që gjenden në shkresat e kësaj lënde.

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarëve, manifestohen të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale me të cilën me të cilën në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor-neni 188 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Me rastin e caktimit të llojit dhe matjes së lartësisë së dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e tij në kuptim të nenit 73 të KPRK-së. Si rrethana lehtësuese për të akuzuarit [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] mori atë se e kanë pranuar fajësinë për veprën penale, pendimin për veprën penale të kryer, kanë treguar sinqeritet gjatë procedurës penale, i kanë kërkuar falje të dëmtuarit [REDAKTUAR] nga ky rast me të dëmtuarin [REDAKTUAR] më nuk kanë pas të keqe, dhe nuk do ta pengojn në ushtrimin e veprimtarisë së tij ku edhe këto e kanë të jëjtë, mbi bazën e këtyre rrethanave gjykata vlerësoi shkallën e përgjegjësisë penale dhe rrezikshmërinë konkrete të kësaj veprave penale dhe të akuzuarve i shqiptoj sanksionin penalit i s si në diapozitiv të aktgjykimit, duke qenë e bindur se një dënim i tillë është në proporcion dhe raport me peshën e veprës konkrete penale, rrethanave të kryerjes si dhe personalitetin e të akuzuarit dhe me te arrihet qëllimi ndëshkues në kuptim të preventivës speciale që i akuzuari të mos kryejë vepra penale si dhe në kuptim të preventivës së përgjithshme të parandalimit të kësaj veprë penale në shoqëri komfor nenit 41 të KPRK-së.

Konformë nenit 463 parag.1 lidhur me par 3.të KPPK-së të dëmtuarin [REDAKTUAR] nga Ferizaj rruga " [REDAKTUAR] ", për realizimin e kërkeses pasuroro-juridike janë udhëzuar në kontest civil.


Konformë nenit 450 par.2.6 të KPPK-së gjykata ka obliguar të akuzuarit në mënyr solidare, për shpenzimeve gjyqësore të paguajn shumën prej 20 Euro si dhe paushallin gjyqësor në shumën prej 60 Euro, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Nga sa u tha më lart është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**  
Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal,  
P.nr.2028/2017 me datë 16.01.2018

Zyrtar Ligjor  
Blend Rexhepi

Gjyqtari  
Adem Shabani



**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar, ankesa në, afat prej 15 ditësh. nga dita e pranimit, Gjykatës, së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.